

KËRKESË
Nr. 1624, datë 27.5.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“FERMER TRADE”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- **“FERMER TRADE”**

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000304-5

Datë: 10.5.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000304-2, datë 16.4.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin FERMER TRADE, NIPT K92302031C, përfaqësues i autorizuar i subjektit Murat Klobocishta (Administrator), prej datës 10.4.2019, ora 09:00 deri më datën 10.4.2019, ora 16:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 16.4.2019 dhe e njoftoi në datën 16.4.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 10463, datë 22. 9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 62, pika 4.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve ", datë 4.16.2019, neni/neneve 62, pika 4. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti pranë ISHMPUT-së Tiranë me nr. 695 prot., më datën 18.4.2019, rezultoi se mungonin dokumentat e transferimit të mbetjeve dhe kontrata me subjekt të licensuar. Në deklaratën e tij, subjekti shprehet se i trajton vetë mbetjet e veta, gjë kjo, e cila bie në kundërshtim me ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, neni 62, pika 3, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 500 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm.

Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

- Menaxhimi dhe plotësimi i dokumentacionit të menaxhimit të mbetjeve sipas legjislationit në fuqi.

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Gerson Tafa ID: 0301020014

Gezim Ruci ID: 0301020015

Ueda Damjani ID: 0301020034

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti FERMER TRADE ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.